



This project is funded by the European Union



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSPEKTORATI I LARTE I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE DHE KONFLIKTIT TE INTERESAVE



Praktika pozitive ndërkombëtare mbi instrumentin e sinjalizimit

“Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka zhvilluar gjithashtu parime për mbrojtjen e sinjalizuesve (edhe pse në raste të pakta) në vështrim të nenit 10 të KEDNJ-së (liria e shprehjes).”

Në rastin **Guja kundër Moldavisë**, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mori në shqyrtim çështjen e aplikantit, i cili ishte pushuar nga puna pasi së bashku me kolegun e tij prokuror kishin dërguar tek Gazeta e Kishinevit dy letra që evidentonin presionin e ushtruar nga Kryetari i Kuvendit dhe Zv.Ministri i Brendshëm të cilat vërtetonin, se zyrtarët publikë po ushtronin presion mbi organet e drejtësisë. Motivacioni i pushimit nga punë – letrat ishin sekrete dhe mbi to nuk ishte shënuar fjala konfidenciale.

GJEDNJ vuri në dukje, se "interesat që publiku mund të ketë për t'u informuar në disa raste të veçanta ndonjëherë mund të jenë aq të forta sa të tejkalojnë edhe detyrimin ligjor për të heshtur". Praktika e ndërhyrjes së politikës në drejtësi përbënte një shqetësim për vendin dhe kishte interes të lartë publik.

Në çështjen **Heinisch kundër Gjermanisë**, GJEDNJ pohoi që "interesi publik për të qenë i informuar për cilësinë e shërbimeve publike është më i madh se interesat e mbrojtjes së reputacionit të punëdhënësit. Znj. Heinisch (aplikantja) sinjalizoi publikun kur ajo zbuloi informacion mbi mangësitë në kujdesin e ofruar nga institucioni shëndetësor publik ku ajo punonte si infermiere.

Kontrata e saj e punës u ndërpre më vonë, gjë që Gjykata konstatoi se ishte ndërhyrje në lirinë e shprehjes së aplikantes, garantuar sipas nenit 10 të Konventës.

Gjykata gjeti se ajo kishte bërë ankesa të brendshme të mjaftueshme përpara se të bënte një kallzim penal.

KONSTATIME

Përveç konventave dhe raporteve, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) është burim shumë i rëndësishëm për të analizuar zhvillimet ligjore dhe mbrojtjet. Ndryshe nga shumica e instrumenteve juridikë në terren, praktika gjyqësore nuk e trajton çështjen e sinjalizimit nga lloji i informacionit por përkundrazi ajo që ka rëndësi thelbësore është se sinjalizimi është një shfaqje praktike e lirisë së shprehjes siç përcaktohet në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (Neni 10 i KEDNJ).



“Sinjalizimi publik sipas qëndrimit të GjEDNj-së duhet konsideruar si mjete i fundit, pasi nëpunësi civil të jetë konsultuar me një "autoritet epror, apo autoritet tjetër kompetent”.

Ky material realizohet në kuadër të zbatimit të projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit – nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane” e mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e materialit, në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian. Ajo është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.”